


**RAPORT**  
**I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK**  
**Për Programin e studimit**  
**BSc Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare**  
**UNIVERSITETI "EPOKA"**

**Ekspert i vlerësimit të jashtëm:**

**Prof. Asoc. Dr. Afrim Krasniqi**



QERSHOR, 2017

## RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

### Për Programin e studimit BSc Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare, EPOKA

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Universiteti EPOKA
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	VKM Nr. 281, datë 12.03.2008
	Urdhër riorganizimi	Urdhër Nr. 213, datë 25.05.2012
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	UMASH Nr.260, datë 07.06.2011 (*)
5	Titulli i programit të studimit:	Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare
6	Cikli i studimit:	Bachelor
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vjet
8	Kreditet në total (ECTS):	180 Kredite (ECTS)
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha angleze
11	Programi ofrohet nga institucioni	EPOKA
12	Programi ofrohet në bashkëp. me institucione të tjera	Jo
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin)	Jo
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin)	Jo
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	6
16	Aktivizimi i programit të studimit	2008-2009

\*Sipas Urdhërit të Akreditimit Nr. 260, datë 07.06.2011, ky program studimi është akredituar si; Bachelor në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare **me kohëzgjatje normale 4 vite**. Eshtë hera e parë që ky program studimi i nënshtohet procesit të akreditimit pas riorganizimit të tij me Urdhër Nr. 213, date 25.05.2012, si Bsc në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare **me kohëzgjatje normale 3 vite**.

## **HYRJE**

Programi i studimeve bachelor "Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare" zhvillohet në Fakultetin e Shkencave Ekonomike dhe Administrative në Universitetin EPOKA. Programi, me kohëzgjatje normale të studimeve prej katër vitesh akademike (240 ECTS) u licencua në bazë të Vendimit Nr. 281, datë 12.03.2008, të Këshillit të Ministrave dhe u bë pjesë e akreditimit institucional konfirmuar në Urdhrin Nr. 260, datë 07.06.2011, të MASH. Me vendim të Universitetit dhe Urdhër nr. 213, datë 25.05.2012, të MASH, programi Bachelor në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare u riorganizua në program me kohëzgjatje të studimeve prej tre vitesh akademike (180 ECTS). Pas këtij procesi nuk ka pasur akreditimi të programit të ri të ndryshuar. Sipas Universitetit EPOKA, Urdhri i Riorganizimit Nr. 213, datë 25.05.2012, si dhe Vendimi Nr. 313, datë 16.03.2012, i Këshillit të Akreditimit, nuk është kërkuar që programi i riorganizuar i studimit Bachelor në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare t'i nënshtrohet përsëri procesit të akreditimit. Ndërkohë, universiteti EPOKA ka paraqitur kërkesën e akreditimit periodik dhe mbi këtë kërkesë APAAL me dt.30.05.2017 ka caktuar grupin e punës dhe ekspertin e jashtëm të vlerësimit të cilësisë.

### **I. GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)**

Përbërja e GVJ: Bordi i Akreditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën Prof. As. Dr. Afrim Krasniqi si ekspert i jashtëm i vlerësimit të këtij programi studimi. Gjatë gjithë procedurës, eksperti i vlerësimit është asistuar nga specialistia e ASCAL Znj. Xhiliola Bixheku.

### **ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË**


Në Urdhërin e akreditimit të parë të këtij programi studimi Nr. 176, datë 30.05.2011, akreditimi është pozitiv. Universiteti EPOKA ka pasur tre rekomandime për këtë program.

- Të zgjerohet literatura shkencore me natyrë politike, diplomatike, sociale e historike vendase dhe e huaj në bibliotekë si nga larmia ashtu edhe nga tirazhi.
- Të stimulohet puna individuale e studenteve gjatë zhvillimit të procesit mësimor, duke i dhëne përparësi orëve te veçanta të seminareve, prezantimeve me gojë dhe eseve te ndryshme.
- Të shikohet mundësia për shtimin e numrit të pedagogëve të brendshëm dhe të jashtëm për të siguruar nje mbulim të plotë dhe më të mirë të procesit mësimor.

#### **Lidhur me plotësimin e rekomandimeve:**

1. Literatura shkencore ka pasur zgjerim dhe pasurim, sidomos me literaturë të huaj dhe përmes burimeve online për stafin dhe studentët. Biblioteka është pasuruar me tituj të rinj dhe akses më të madh në burimet bibliotekare online. Progresi për zgjerimin me literaturë vendase është minimal. Nevojitet pasurimi më tej me literaturë politike, diplomatike, sociale e historike vendore, pavarësisht se tekstet janë kryesisht shqip dhe studentët preferojnë tekste anglisht.

2. Struktura e mësimdhënies dhe organizimi i procesit mësimor janë përshtatur me kërkesat e rekomandimit.
3. Me plotësimet në staf aktualisht ai është i mjaftueshëm për përballimin e ngarkesës mësimore referuar edhe numrit të studentëve që ndjekin studimet në shkencat politike dhe marrëdhëniet ndërkombëtare.



## ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

### 1. MISIONI/OBJEKTIVAT E PROGRAMIT TË STUDIMIT

#### Pjesa përshkrimore

**TERMA REFERENCE:** Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Universiteti EPOKA është themeluar në përputhje me kërkesat e legjislacionit për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë dhe ka si mision *“të jetë një institucion mësimor-kërkimor inovativ dhe me ndikim, në shërbim të vlerave njerëzore thelbësore nëpërmjet prodhimit, shpërndarjes dhe zhvillimit të dijeve në nivel ndërkombëtar, si dhe të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së jetës së shoqërisë mbështetur në nevojat kombëtare dhe rajonale”*<sup>1</sup>. Sipas dokumenteve kryesore të Universitetit EPOKA ndër qëllimet kryesore të tij është<sup>2</sup> *“të përgatisë specialistë të lartë, në përputhje me kërkesat dhe nevojat e shoqërisë në ndryshim dhe zhvillim, në fushën ....drejtësisë, shkencave politike e marrëdhënies ndërkombëtare, si dhe shkencave të tjera sociale me formim të përgjithshëm nëpërmjet programeve universitare mësimore-shkencore të një niveli të përparuar e bashkëkohor teorik, metodik e praktik”*. Gjithashtu qëllim primar mbetet *“të ofrojë studime të thelluara akademike dhe të kryejë kërkime shkencore në fushat e studimit... të kryejë kualifikime për specialiste të lartë... të integrojë mësimdhënien me kërkimin shkencor, si dhe...të tërheqë specialistët më të mirë dhe të inkurajojë me të gjitha mënyrat kontributin e tyre vazhdimisht në rritje në fushat përkatëse”*.

Referuar shkencave politike dhe marrëdhënies ndërkombëtare, mision kryesor përcaktohet *“përgatitja e individëve të kualifikuar për karrierë në sektorin privat, publik dhe organizata jo-fitimprurëse, duke siguruar një arsimim të gjerë profesional dhe shkencor....të trajnojnë lidera të rinj dhe të aftë, duke vendosur standarde në përmbajtjen akademike dhe cilësinë e mësimdhënies”*. Sipas RVB vizioni i Universitetit EPOKA në fushën e shkencave politike dhe marrëdhënies ndërkombëtare është *“shndërrimi i tij në një program lider në Shqipëri dhe në rajon në aspektin e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe zhvillimit, si dhe kontributit ndaj shoqërisë...të përgatitë të diplomuar cilësorë dhe të aftë si nga ana profesionale ashtu edhe në fushën e kërkimeve shkencore”*.

Universiteti EPOKA ka një strategji afatgjatë orientimi, deri më 2022, dhe me fokus shkencat politike dhe marrëdhëniet ndërkombëtare synon<sup>4</sup> *“të avancojë dukshëm numrin e saj të studentëve, cilësinë e mësimdhënies, kërkimin shkencor dhe menaxhimin e departamentit”*, si dhe ta *“shohë veten si lider për studimin e shkencave politike dhe marrëdhënies ndërkombëtare në Shqipëri dhe më gjerë”*. Kjo sipas saj, do arrihet edhe përmes *“rritjes së cilësinë së studentëve të regjistruar, duke ndërkombëtarizuar trupin studentor, duke forcuar cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor dhe duke përmbushur pritshmëritë e studentëve dhe stafit”*.

Misioni, qëllimet, vizioni dhe objektivat e theksuara më lart dhe të detajuara në dokumentet zyrtare të Universitetit EPOKA, përfshirë në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm u verifikuan dhe u gjetën të aplikuara në tërësinë e funksionit institucional gjatë vizitës së ekipit të ekspertëve në institucion.

<sup>1</sup> Statuti i Universitetit EPOKA, Miratuar me Vendimin e Senatit Akademik nr. 02, datë 14.12.2016.

<sup>2</sup> Statuti i Universitetit EPOKA, neni 3, Tiranë, 2016.

<sup>3</sup> Raport i Vlerësimit të Brendshëm, EPOKA, shkurt 2017.


<sup>4</sup> Raport i Vlerësimit të Brendshëm, EPOKA, shkurt 2017.



## VLERËSIMI SIPAS STANDARDEVE

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve <sup>5</sup>
<b>I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Shkenca Politike dhe në Marrëdhëniet Ndërkombëtare është në përputhje me misionin e institucionit të përcaktuar në <i>Planin Strategjik</i> të Universitetit EPOKA deri 2022.</p> <p>Programi ka objektiva të përcaktuara qartë lidhur me formimin e studentëve. Universiteti EPOKA provoi përmes përvojës dhe dokumentacionit se studentët pajisjen me njohuritë e nevojshme të nivelit të studimit, duke ndërthur kuadrin teorik, me specializimet e avancuara, shkëmbimet dhe praktikat profesionale.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare, bazuar në të dhënat e institucionit, reflekton në tërësi nevojat e tregut të punës. Zhvillimi i lëndëve në gjuhën angleze përbën një investim pozitiv për studentët dhe stimul të rëndësishëm adresuar nevojave/kërkesave të tregut të punës brenda dhe jashtë Shqipërisë.</p> <p>Programi i studimit është në harmoni me zhvillimin ekonomik të vendit, është në përputhje me politikat kombëtare të parashikuara në planin strategjik mbi arsimin e lartë të Ministrisë së Arsimit dhe të Sportit, si dhe trajton funksionimin e politikave kombëtare dhe ndërkombëtare.</p>
<b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve të ciklit</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare gjen harmoni të plotë me strategjitë e zhvillimit afatgjatë të institucionit, si dhe strategjinë e vetë departamentit.</p> <p>Programi Bachelor në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare aplikon standardet e njohura të parimeve të Kartës së Bolonjës, ka metodologji të avancuar të metodave e parimeve shkencore, sipas praktikave ndërkombëtare.</p> <p>Programi mbetet unik në praktikën e universiteteve tona, pasi bashkon njohuritë mbi</p>

<sup>5</sup> GVJ duhet të shprehen me shkrim për të gjitha standardet (bazuar në kriteret përkatëse). Në fund të çdo rubrike grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardit në tërësi.



të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale dhe specialitetesh. Në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;

shkencat politike dhe marrëdhëniet ndërkombëtare, si dhe në elementë të veçantë, ofron njohuri praktikë juridike dhe ekonomike plotësuese, duke ndihmuar që produkti i studimeve të jetë i larmishëm dhe në funksion të studentëve, strategjisë së institucionit, qëllimeve dhe nevojave të tregut. Studentët e diplomuar vijnë studimet në nivelet e tjera duke synuar nxjerrjen e ekspertëve të studimeve politike, marrëdhënies ndërkombëtare, diplomacisë, konsulentëve, menaxhim, administrim politik, aktivist politik, etj. Të diplomuarit gjatë viteve kanë arritur të identifikohen me sukses në fusha të tilla.

**II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE**  
**Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.**

**Kriteri 1** Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;

Programi i studimit Bachelor në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare ka fokus strategjik tregun e brendshëm dhe të jashtëm, kryesisht për shkak të formimit akademik dhe mësimdhënies në gjuhën angleze. Universiteti ka zhvilluar mekanizma të ndryshëm që ofrojnë përputhje të këtyre politikave me strategjitë e zhvillimit ekonomik kombëtar.

**Kriteri 2** Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:

Universiteti Epoka ka në fokus prioritar të tij nevojat e tregut kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar. Për këtë arsye programi i studimit fokusohet në këto drejtime, mësimi zhvillohet anglisht, standardet krahasuese merren nga modele pozitive ndërkombëtare dhe stafi akademik është ndërkombëtar.

a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar;

a) Universiteti ka krijuar mekanizma për studimin e tregut sipas fokusit të mësipërm, dhe është përpjekur të krijojë përputhshmëri midis ofertës akademike dhe kërkesave specifike aktuale e të ardhshme të tregut. Ai ka krijuar marrëveshje me një numër institucioneve brenda e jashtë vendit, për shkëmbim e bashkëpunim në këtë fushë, si dhe për specializime të avancuara.

b. kërkesat e punëdhënësve;

b) Universiteti ka marrë në konsideratë kërkesat e punëdhënësve potencialë dhe pritshmëritë e tyre në fushën e shkencave politike dhe marrëdhëniet ndërkombëtare;

c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;

c) Universiteti ka parashikuar regjistrimin e 20-40 studentëve për vit akademik në këtë degë studim

d) Universiteti konsideron se numri i

<p>d. Numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</p>	<p>programeve të njëjta të ofruar nga universitete brenda vendit është minimal, dhe se numri i studentëve në to është relativisht në kuota të njëjta. Dhënia prioritet i gjuhës angleze dhe literaturës ndërkombëtare në këtë gjuhë është vlerësuar si masë ndihmëse për studimeve të avancuara në vendet e tjera.</p>
<p><b>Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi studimit Bachelor në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare është në përputhje me parimet e Kushtetutës së Shqipërisë, legjislacionin, aktet e MAS dhe promovon demokracinë dhe shtetin e së drejtës.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare promovon njohjen dhe kultivimin e vlerave kulturore kombëtare tek studentët &amp; stafi shqiptar dhe i huaj, studentët inkurajohen të angazhohen në projekte “me përgjegjësi sociale”, si dhe ata kanë realizuar projekte të ndryshme që reflektojnë kërkesat e këtij kriteri.</p>
<p><b>Konkluzione të GVJ:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ <i>Programi i studimit Bachelor në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare është ndërtuar dhe zhvilluar në përputhje me misionin, qëllimin, prioritetet e institucionit;</i></li> <li>✓ <i>Programi reflekton përcaktimet strategjike të institucionet deri në vitin 2022;</i></li> <li>✓ <i>Programi ka krijuar një lidhje organike midis ofertës akademike dhe nevojave të tregut të punës në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar;</i></li> <li>✓ <i>Programi zhvillohet në gjuhën angleze dhe krijon facilitetet pozitive për studentët lidhur me tregun e punës dhe prespektivën e studimeve;</i></li> <li>✓ <i>Programi është në përputhje me legjislacionin shqiptar, me parimet e Kartës së Bolonjës, si dhe me politikat dhe interesat kombëtare. Ai ruan e kultivon vlerat kulturore kombëtare.</i></li> <li>✓ <i>Programi i përmbush kriteret e kërkuara në këtë kapitull vlerësimi.</i></li> </ul>	

## 2. STRUKTURA AKADEMIKE E FAKULTETIT (PËRGJEGJËS PËR PROGRAMIN E STUDIMIT)

### Pjesa përshkimore


**TERMA REFERENCE:** përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Fakulteti, Organizimi hierarkik i Fakultetit

Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative është pjesë e Universitetit EPOKA dhe përbëhet nga katër departamente:

- a) Departamenti Financë Bankë
- b) Departamenti Administrim - Biznes





- c) Departamenti Ekonomik
- d) Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare

Katër departamentet kanë në programet e tyre studimore lëndë bazë ndërdisiplinore dhe lëndë të profilizuara. Personeli akademik që jep mësim në programin Bachelor në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare vitin akademik 2016-2017 është personel akademik efektiv (11) dhe personel me kontratë (4). Krahas stafit akademik është edhe stafi administrativ (4 persona). Tipar i vecantë i stafit akademik është qenia ndërkombëtare (profesorë nga Turqia, nga Kosova, nga Shqipëria dhe vende të tjera). Të dhënat e detajuara mbi stafin akademik dhe administrativ janë pasqyruar në RVB dhe të verifikuara nga ana jonë (Referohu në Tabelën 5, 7, 8 dhe 9, faqe 21 dhe 23-24 të RVB).

- Organet e zgjedhura në të gjitha nivelet
  - Universiteti ka bërë unifikimin e strukturave drejtuese me kërkesat e ligjit të ri të arsimit të lartë. Organi kryesor drejtues është a) Senati Akademik; b) Rektorati; c) Dekanatet; d) Asambletë e personelit akademik të njëjësive kryesore; e) Këshilli i Etikës; f) Komisioni i Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik, g) Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë; h) Komisioni i Përhershëm për Marrëdhëniet me Studentët; i) Komisioni i Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor” j) Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë; k) Bordi i Administrimit.
  - Bazuar në nenin 39 të Statutit<sup>6</sup> Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegjal administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të Universitetit, si dhe qëndrueshmërinë financiare dhe administrative të tij. Bordi i Administrimit mbikëqyr dhe kontrollon veprimtaritë e Universitetit që lidhen me menaxhimin administrativ, financiar, ekonomik dhe të aseteve të tij. 2. Anëtarët e Bordit të Administrimit të Universitetit emërohen nga Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë Themeluese për një periudhë pesëvjeçare, me të drejtë riemërimi.
  - Sipas Statutit të Universitetit EPOKA “Senati Akademik është organ kolegjal vendimmarrës i Universitetit. Ai përcakton politikat e zhvillimit të institucionit, programon, bashkërendon, drejton dhe krijon 13 mekanizma për kontrollin e veprimtarive të mësimdhënies e të kërkimit shkencor dhe vlerëson efikasitetin e tyre, si dhe vendos për problemet më të rëndësishme mësimore dhe shkencore të institucionit. Ai përbëhet nga 15 anëtarë, mblidhet periodikisht gjatë vitit dhe ka një mandat katërvjeçar”<sup>7</sup>.
  - Rektorati është organ kolegjal ekzekutiv. *Rektorati përbëhet<sup>8</sup> nga: a) Rektori; b) Zëvendësrektori/ët; c) Dekani i çdo fakulteti, d) Administratori i Universitetit; e) Koordinator i Studentëve; f) Zëvendëskoordinatori i Studentëve; g) Përgjegjësi i Zyrës Ligjore.* Rektori propozohet nga Senati Akademik dhe emërohet me vendim të Bordit të Administrimit, në përputhje me dispozitat e këtij Statuti për një periudhë katërvjeçare me të drejtë riemërimi vetëm një herë në të njëjtin pozicion. Sipas pikës 4 Rektori i Universitetit dekretohet nga Presidenti i Republikës<sup>9</sup>. ***Duhet thënë se ky përcaktim nuk është aplikuar në rastin e universiteve jo publike në Shqipëri.***

<sup>6</sup> Statuti i Universitetit EPOKA, neni 39, Tiranë 2016.

<sup>7</sup> Statuti i Universitetit EPOKA, neni 15, Tiranë 2016.

<sup>8</sup> Statuti i Universitetit EPOKA, neni 22, Tiranë 2016.

<sup>9</sup> Statuti i Universitetit EPOKA, neni 47, Tiranë 2016

- Dekani, është autoriteti drejtues i fakultetit. Ai drejton fakultetin, është anëtar i senatit, dhe ushtron kontrollin e ligjshmërisë mbi autoritetet drejtuese brenda fakultetit. **Ndryshe nga sa përcaktohet në Ligjin nr.80/2015 apo në Ligjin e mëparshëm të Arsimit të Lartë (2007) dekani nuk zgjidhet nga personeli akademik dhe studentët**, por emërohet nga Rektori pas miratimit të Senatit Akademik për një periudhë katërvjeçare, me të drejtë riemërimi vetëm një herë në të njëjtin pozicion. Për postin e Dekanit mund të kandidojnë individë të personelit akademik të fakultetit përkatës ose individë jashtë tij që i përkasin kategorisë “Profesor”<sup>10</sup>.
- Këshilli i Fakultetit është organ kolegjal vendimmarrës në fakultet. Këshilli i Fakultetit përbëhet nga Dekani, i cili drejton Këshillin, shefat e departamenteve, drejtorët e qendrave kërkimore të zhvillimit, si dhe një anëtar i stafit akademik. Kohëzgjatja e Këshillit të Fakultetit është katër vjet. Një nga funksionet e tij është zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Administrativ të Fakultetit, organ i cili përcakton në bazë të propozimeve të departamenteve përdorimin e burimeve njerëzore dhe materiale në dispozicion të fakultetit. **Nga verifikimi reuzltoi se përbërja e Këshillit të Fakultetit dhe Këshillit Administrativ ishte 100% e njëjtë, pra që Këshilli i Fakultetit ka propozuar vetveten për Këshill Administrimi, praktikë që meriton të marrë zgjidhje me demokratike dhe më funksionale në të ardhmen.**
- Përgjegjësi i Departamentit sipas Statutit të Universitetit EPOKA është autoriteti drejtues i Departamentit. Ai propozohet nga Dekani ndërmjet anëtarëve të personelit akademik me kohë të plotë të njësisë bazë dhe emërohet nga Rektori pas miratimit nga Senati Akademik, për një periudhë katërvjeçare, me të drejtë riemërimi vetëm një herë në të njëjtin pozicion<sup>11</sup>. Pra, **ndryshe nga sa përcaktohet në Ligjin nr.80/2015 apo në Ligjin e mëparshëm të Arsimit të Lartë (2007) Përgjegjësi i Departamentit nuk zgjidhet nga stafi akademik.**

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion:

**Nga verifikimi i dokumenteve të funksionimit të Universitetit EPOKA, ashtu sic edhe në raste të njëjta të universiteteve jopublike në Shqipëri, pozicionet drejtuese bazohen kryesisht në emërim dhe jo në zgjedhje. Rekomandohet respektimi i Ligjit për Arsimin e Lartë dhe Kërkimit Shkencor nr. 80/ntit.**

**2015 që kërkon zgjedhje të drejtuesve, që nga Rektori deri tek Përgjegjësi i Departame**

<sup>10</sup> Statuti i Universitetit EPOKA, neni 51, Tiranë 2016

<sup>11</sup> Statuti i Universitetit EPOKA, neni 55, Tiranë 2016

### 3. PERSONELI AKADEMIK DHE PERSONELI MBËSHTETËS PËR PROGRAMIN E STUDIMIT

#### Pjesa përshkrimore

**TERMA REFERENCE:** Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

#### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, ( Nga verifikimi i tabelave të paqyruara në RVB)

Në Programin e studimit Bachelor në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare, gjatë vitit akademik 2016-2017 janë angazhuar 15 anëtarë të personelit akademik, 11 staf i brendshëm i Departamentit dhe 4 staf me kontratë. Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare ka vetëm një anëtar me titullin "Profesor i Asociuar". Përgjegjësi i Departamentit dhe katër pedagogë të tjerë kanë gradën shkencore "Doktor", dy pedagogë janë doktorantë dhe tre pedagogë kanë diplomë të nivelit Master. Një pjesë e lëndëve në programin e studimit Bachelor në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare plotësohet nga stafi akademik i departamenteve të tjera të Fakultetit. Gjithashtu një pjesë e ngarkesës mbulohet nga pedagogët me kontratë, nga të cilët, tre kanë titullin "Profesor Doktor".

Ngarkesa e personelit akademik përbëhet prej 3 komponentësh: a) mësimdhënie; b) punë kërkimore shkencore; c) punë në mbështetje të institucionit. Të dhënat e ndara me përqindje nuk janë reflektuar në RVB, por u konstatuan nga takimi me stafin e pedagogëve. Sipas këtyre të dhënave, ngarkesa mësimore në programin e studimit Bachelor në Shkenca Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare në semestrin e vjeshtës për vitin akademik 2016-2017, për pedagogët më e kohë të plotë dhe kohë të pjesshme ishte si më poshtë: 1- Pedagogët më e kohë të plotë – 72 % të ngarkesës mësimore; për Pedagogët më e kohë të pjesshme – 28 % të ngarkesës mësimore. Edhe në verifikimin e kontratave të punës secili anëtar i personelit akademik, në varësi nga titulli dhe funksioni, kishte të specifikuar detyrat, angazhimet dhe përgjegjësitë.

Nga zyra e burimeve njerëzore / personelit u informuam se kriteret kryesore të zgjedhjes së stafit akademik janë klasike, - lidhen me përvojën, CV profesionale, titujt akademikë, fushën e kërkimit, etj. Për vetë natyrën e universitetit, specifikisht kërkohen njohuri të thelluara të gjuhës angleze, formim profesional në lëndët specifike. Pjesa më e madhe e stafit akademik shqiptar kishte studiuar pjesërisht ose një cikël studimi në sistemin arsimor e universitar të Turqisë, si dhe pjesa e stafit ndërkombëtar kishte përvojë të gjatë pune në universitete turke dhe në vende të tjera.

Sipas Statutit të Universitetit EPOKA punësimi i personelit akademik<sup>12</sup> kriteret e punësimit përcaktohen nga njësia bazë, në varësi nga nevoja. Praktika e testimit dhe e vendimmarrjes ndryshon midis përcaktimeve në statut dhe praktikës së referuar nga RVB. Sipas statutit konkursi drejtohet nga një Komision i zgjedhur nga Dekani, propozimi i emrit fitues i kalon rektoratit dhe vendimi final merret nga Bordi i Administrimit. Sipas RVB përzgjedhja e kandidatëve për personet bëhet sipas kësaj

<sup>12</sup> Statuti i Universitetit EPOKA, neni 68, Tiranë 2016



praktike: Departamenti dhe Fakulteti njofton interesin për personel të ri. Kandidatët paraqesin aplikimet anglisht, dokumentacioni kalon nga zyra e burimeve njerëzore në Fakultet. Bordi Administrativ zgjedh një komision me 3 akademikë, të cilët marrin në pyetje kandidatët. Vendimi i Bordit i shkon Bordit Administrativ të Universitetit, i cili pas shqyrtimit ia kalon Këshillit të Lartë të Universitetit, i cili jep vendimin përfundimtar. Praktika duket shumë strikte, por gjykohet se është pozitive për një universitet me personel ndërkombëtar dhe me gjuhën angleze si gjuhë mësimi dhe pune.

Të gjithë treguesit e vendosur në tabelat 7, 8 10, 11, 12 mbi të dhënat e stafit, kualifikimin etj, të ndodhet në faqen 22-25 të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, u verifikuan dhe janë të saktë. Konkretisht,

- Të dhënat mbi stafin, kualifikimin dhe raportet mes tyre (Referohu në Tabelën 7, 8 dhe 9, faqe 23 RVB)
- Të dhënat sipas seksit (Referohu në Tabelën 10, faqe 24 RVB)
- Të dhëna sipas moshës së personelit (Referohu në Tabelën 11 dhe 12, faqe 24 RVB)
- Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat
- Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë
- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

### VLERËSIMI SIPAS STANDARDEVE

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
<b>III - PERSONELI I INSTITUCIONIT</b>	
<b>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>	<p>Institucioni zbaton praktika transparente dhe ligjore të rekrutimit të personelit, por instrumentat e vendimmarrjes kanë dallime midis atyre të referuara në RVB dhe në Statutin e Universitetit.</p> <p>Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programin Bachelor Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare përbën 73% të gjithë stafit të angazhuar në këtë cikël studimesh.</p> <p>Universiteti EPOKA dhe fakulteti e departamenti ku zhvillohen studimet në shkenca politike e marrëdhënie ndërkombëtare ofroi të dhëna të besueshme për praktikat transparente dhe të vazhdueshme të vlerësimit të personelit akademik. Vlerësimi bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me praktikat më të mira akademike. Universiteti ofron stimul financiar për stafin akademik me arrije profesionale, si dhe një sistem kontrolli të vazhdueshëm në nivel akademik dhe në nivel të raporteve me studentët dhe rregullat etike.</p> <p>Zyra e Burimeve Njerëzore ka të dhëna të detajuara të dosjeve mbi rastet e rekrutimit të</p>



	personelit, në të gjitha etapat e kësaj veprimtarie.
<b>Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore "Doktor, ose titullin akademik "Docent".</p>	<p>Institucioni disponon një bazë të dhënash të detajuara për anëtarët e personelit akademik. Të dhënat hidhen në sistemin interaktiv të Universitetit (EIS) për të gjithë personelin, shqiptar dhe të huaj, si dhe kanë informacionet kryesore që lidhen me stafin dhe aktivitetin e tyre akademik.</p> <p>Institucioni dispononte listën e plotë të personelit akademik (personel me kohë të plotë, personelit ndihmës mësimor shkencor dhe atij administrativ) të angazhuar për çdo semestër dhe sipas raportimit, nuk ka pasur devijim nga kjo listë gjatë vitit të fundit akademik, pavarësisht se një pjesë e stafit akademik që angazhohet në aktivitete të ndryshme apo lëndë të veçanta është i huaj.</p> <p>Institucioni i publikon të gjitha të dhënat që lidhen me procesin e rekrutimit, (njoftimet për vendet e lira, kriteret, afatet, përfundimet, etj), në faqen e tij zyrtare dhe në media të ndryshme, si dhe njofton autoritetet zyrtare të punësimit.</p> <p>Personeli akademik i angazhuar, i përmbush kërkesat e këtij kriteri. Titullarët e lëndëve/moduleve janë gradën "Doktor" ose përmbushin kriteret e ligjit mbi arsimin e lartë për këtë nivel studimi. Nga personeli i brendshëm, rezultoi se 5 pedagogë kanë gradën "Doktor", dy janë doktorantë, dhe tre kanë përfunduar studimet master.</p>
<b>Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1</p>	<p>Institucioni dëshmoi se ka angazhim maksimal të personelit ndihmës për realizimin e detyrimeve akademike, mësimore dhe aktivitetev plotësuese, - një tipar i njohur i universiteteve jopublike. Sistemi kompjuterik dhe elektronik ishte në funksion të personelit dhe studentëve, si dhe asistentët kërkimorë ndihmojnë stafin për realizimin e orëve praktike dhe mirëmbajtjen e mjediseve.</p> <p>Mënyra e ndarjes së ngarkesës mësimore, numri relativisht i madh i stafit të brendshëm akademik, etj, janë tregues se institucioni ka angazhim optimal të burimeve njerëzore për objektivat e programit në shqyrtim.</p> <p>Praktika e punës në Universitetin EPOKA nuk kushtëzon detyrimisht studentin për kryerjen e praktikës profesionale. Megjithatë studentët që dëshirojnë të bëjnë praktikë, asistohen nga stafi</p>

tutor/instruktor për 12 studentë).	akademik dhe zyrat e tjera përgjegjëse në rang fakulteti dhe universiteti. Në këtë rast personeli akademik luan rol koordinues dhe mbikqyrës për studentët e praktikës.
<b>Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimit-shkencor;	Institucioni aplikon disa forma mbështetëse për kualifikimin e mëtejshëm të stafit: trajnime periodike, ligjërata dhe takime me profesorë të ftuar nga jashtë, mundësi administrative për ndjekjen e studimeve të avancuara, mbështetje financiare në rast konferencash të rëndësishme, promovim individual, etj.
<b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të Kualifikimeve të ofruara.	Institucioni ruan dokumentacion të rregullt me të gjitha të dhënat e personelit akademik dhe programeve të kualifikimit, përfshirë pjesëmarrjen dhe rezultatet e saj.
<b>Konkluzione të GVJ:</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ <i>Institucioni zbaton procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit përmes mekanizmave dhe formave të ndryshme bashkëkohore.</i></li> <li>✓ <i>Institucioni përmbush kërkesat ligjore që lidhen me ngarkesën e stafit akademik dhe raportet midis stafit të brendshëm atij me kontratë,</i></li> <li>✓ <i>Institucioni respekton kriteret për caktimin e titullarëve të lëndëve dhe gradën shkencore përkatëse, si dhe mbështet promovimin në gradë të personelit me mastar shkencor.</i></li> <li>✓ <i>Institucioni ka krijuar një numër instrumentesh të brendshme të drejtimit shkencor dhe administrativ, kompetencat e të cilave kanë ende nevojë të kenë një formë të njësuar në të gjithë dokumentacionin e institucionit.</i></li> <li>✓ <i>Institucioni ka të ndërtuar një bazë të plotë të të dhënave për personelin e tij.</i></li> <li>✓ <i>Institucioni ka angazhuar personel ndihmës mësimit shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</i></li> <li>✓ <i>Institucioni kryen kualifikim të vazhdueshëm të personelit të tij akademik në metodat bashkëkohore të mësimdhënies dhe në kërkimin shkencor.</i></li> <li>✓ <i>Universiteti i plotëson kriteret e kërkuara në këtë kapitull.</i></li> </ul>	

#### 4. INFRASTRUKTURA NË FUNKSION TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT, LOGJISTIKA DHE SHËRBIME TË TJERA NDAJ KOMUNITETIT

##### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Gjatë vizitës në institucion u verifikuan të dhënat teknike, të cilat gjenden në detaje në tabelat 13, 14, 15 faqe 30, 31, 32 të RVB).

##### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Mjediset për Programin e studimit
- Salla për leksione
  - Klasa për seminare
  - Salla për aktivitete promovuese
  - Salla për praktikë lëndore/ profesionale
  - Laboratorë për lëndët
  - Laboratorë informatike

- Salla interneti
- Salla për bibliotekë
- Mjedis për fotokopjime, librari etj
- Zyrë informacioni për studentët
- Nyje hidrosanitare

Gjatë vizitës ekipi zhvilloi vizita në mjediset e leksioneve dhe seminareve, në bibliotekë, në mjediset e pushimit dhe të ushqimit, në mjediset e laboratorit elektronik, sallën e kompjuterëve, etj. Mjetet dhe kushtet teknike, të cilat janë në funksion të studentëve dhe stafit akademik, ishin të një cilësie të lartë. Në bibliotekë kishte sallë të mjaftueshmeleximi, mjedis kompjuterik në dispozicion, akses të lirë për studentët dhe stafin për literaturë në internet, si dhe një numër titujsh librash e botimesh cilësore që lidhen me lëndët dhe programin mësimor.

Mjediset për stafin:

- Mjedise për Dekanin/ kancelarin
- Zyra për sekretarinë mësimore
- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore
- Zyra për personelin akademik

Gjatë vizitës u konstatua se personeli akademik ka mjediset të mjaftueshme dhe komode pune, ka akses në internet. Të gjithë drejtuesit e fakultetit dhe departamentit kishin gjithashtu mjediset pune komode dhe të mjaftueshme për ushtrimin e aktivitetit të tyre.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion.

#### **VLERËSIMI SIPAS STANDARDEVE**

<b>Standardet/kriteret</b>	<b>Përmbushja e standardeve</b>
<b>V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI</b>	
<b>Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;	Duke pasur lëndë me karakter kryesisht ndërkombëtar, si dhe anglishten si gjuhë pune, në tërësi tekstet akademike ishin të autorëve të njohur ndërkombëtarë dhe universiteti dispononte titujt më përfaqësues që lidhen me tematikat e lëndëve. Studentët përdorin literaturën bazë dhe literaturë shtesë, sidomos përmes burimeve online në dispozicion. Sugjerimi i ekspertit tonë ishte pasurimi i bibliotekës dhe syllabuseve me literaturë që lidhen me Shqipërinë dhe problematikën kombëtare, pavarësisht se në tërësi këto janë në gjuhë shqip.
<b>Kriteri 2</b> Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;	Në bibliotekë u konstatua se disponohej literaturë anglisht dhe më pak në shqip, në dispozicion të studentëve dhe programit të studimit. Stafit akademik ishte i kënaqur me ineksin e literaturës, kurse studentët u shprehën se do të donin të kishin literaturë shtesë dhe alternative në disa prej lëndëve specifike.



<p><b>Kriteri 3</b> Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;</p>	<p>Në bibliotekë u konstatua se ofrohen botime periodike bashkëkohore dhe literaturë në burime ndërkombëtare elektronike për revista dhe botime të tjera shkencore. Universiteti ka krijuar akses të lirë për studentët dhe stafin në këto burime elektronike, të cilat vazhdimisht pasuroheshin dhe axhornohen.</p>
<p><b>Kriteri 4</b> Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p>	<p>Sipas praktikës së punës së departamentit, stafi akademik mund të sugjerojë tituj të rinj, botime të reja apo periodikë të rinj dhe strukturat vendimmarrëse i vlerësojnë për ti reflektuar pastaj në pasurimin e bibliotekës. Nuk ka buxhet fikse për këto kërkesa, por nuk pati pretendime se ndonjë prej kërkesave është refuzuar.</p>
<p><b>Kriteri 5</b> Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Oraret e bibliotekës në shërbim të studentëve dhe të personelit janë publike dhe përputhjen me pritshmërinë e tyre. Aksesit online është i mundur brenda universitetit dhe nga cdo mjet tjetër kompjuterik, përmes të dhënave personale të stafit apo studentëve.</p>
<p><b>Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p>	<p>Universiteti EPOKA disponon mjedise të shumta mësimi e laboratorit (sallë kompjuterash, mjete të teknologjike, projektorë, mjedise moderne trajnimi, praktike, seminari, etj), të mjaftueshme për realizimin me sukses të mësimin në shkencat politike.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p>	<p>Të gjitha mjediset janë të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme dhe me sistem ajrimi funksional për zhvillimin optimal të procesit mësimor.</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;</p>	<p>Laboratorët kompjuterikë janë të pasur me teknologji bashkëkohore për të përmbushur detyrimin që kërkohet në studimet e shkencave politike e marrëdhënieve ndërkombëtare.</p>
<p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.</p>	<p>Institucioni disponon sallë kompjuterash të mjaftueshëm dhe sistem efektiv interneti në funksion të studentëve dhe mësimin</p>
<p><b>Kriteri 5</b> Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, linguistikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programe stimulimi për shkencat sociale etj.</p>	<p>Programi Bachelor në Shkencat Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare ka në dispozicion laborator me kompjutera, në funksion të lëndëve dhe ecurisë së procesit mësimor, sidomos në fushën e kërkimeve sociale e shkencore.</p>
<p><b>Kriteri 6</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në</p>	<p>Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me disa institucione të tjera akademike dhe jo akademike lidhur me praktikën, si dhe ka</p>



bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.

realizuar praktika studentore pranë institucioneve qendrore politike e kushtetuese, si dhe organizatave të njohura të shoqërisë civile që trajtojnë problematika të marrëdhënieve ndërkombëtare. Institucioni oftoi të dhëna konkrete nga përvoja në këto praktika dhe studentët e konfirmuan rezultatin pozitiv të tyre.

#### **Konkluzione të GVJ:**

- Institucioni ka një sistem aktiv biblioteke, në mjedise, teknologji dhe akses për studentët dhe stafin akademik. Institucioni u ka mundësuar studentëve akses në burimet bashkëkohore të studimeve në shkencë politike dhe marrëdhënie ndërkombëtare. Biblioteka dhe syllabueset kanë nevojë të pasurohen edhe me literaturë profesionale mbi Shqipërinë dhe botën shqiptare, pavarësisht se mësimi bëhet në anglisht.*
- Institucioni ka në dispozicion të studentëve një numër laboratorësh kompjuterikë dhe mjete të tjera të teknologjisë për të mundësuar standarde maksimale mësimi dhe formimi.*
- Institucioni i është përgjigjur kërkesës së studentëve për praktika profesionale, duke mundësuar marrëveshje dhe jetësim të tyre në disa prej institucioneve të rëndësishme politike, kushtetuese dhe civile në vend.*
- Kriteret thelbësore të theksuara në këtë kapitull janë përmbushur.*

## **5. FINANCIMI DHE MENAXHIMI I BURIMEVE FINANCIARE**

### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Të dhënat financiare të departamentit dhe të fakultetit janë pjesë e të dhënave financiare të Universitetit EPOKA. Të dhënat e detajuara mbi kapacitetet, shpenzimet, fitimet dhe elementët e tjerë financiarë gjenden në tabelat 16, 17, 18, 19 në faqet 38 - 40 të RVB.

### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi:
  - Grantet për kërkim
  - Konsulencat, shërbimet
  - Tarifat për dhe gjatë shkollimit
  - Sponsorizimet
  - Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)
  - Donacionet, aktivitetet siguroese, fondacione etj
  - Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)
- Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)
- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

### **VLERËSIMI SIPAS STANDARDEVE**

**Standardet/kriteret**

**Përmbushja e standardeve**

**II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE**  
**Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.**

**Kriteri 1** Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;

**Kriteri 2** Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj;

**Kriteri 3** Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.

Univeristet EPOKA raporton se realizon raport auditit të përvitshëm në kuadër të drejtorisë së përgjithshme të shoqërisë poseduese të Universitetit, Turgut Ozal Educaton, sh.a. Raportet ruhen në Universitet dhe janë në dispozicion për verifikime të mundshme.

Raporti i auditit përfshin të gjitha të dhënat financiare, ku bëjnë pjesë edhe detyrimet financiare, pagat, shpenzimet operative, kontratat me të tretët, investimet e kryera, etj. Sipas vlerësimeve të vetë Universitetit, bilanci financiar i tij është pozitiv dhe garantues për qëndrueshmëri në të ardhmen.

Raporti reflekton edhe të dhënat e detajuara mbi grantet e huaja të përfituara si dhe detyrimet kontraktuale që burojnë nga programi i studimit bachelor në shkenca politike dhe në marrëdhënie ndërkombëtare.

## **VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR**

### **Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.**

**Kriteri 1** Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;

**Kriteri 2** Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;

**Kriteri 3** Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.

Në kuadër të shoqërisë që i përket Universiteti, cdo vit vetë universiteti harton raporte financiare mbi të dhëna të detajuara që lidhen me të ardhurat nga tarifat e shkollimit, të ardhurat e tjera nga shërbimet, si dhe shpenzimet e kryera në funksion të procesit mësimor.

Institucioni deklaroan se ruan dokumentacion të rregullt të raporteve financiare të tri viteve të fundit dhe kopje të tij gjenden në universitet dhe në shoqërinë përkatëse.

Duke marrë të mirëqenë RVB dhe vlerësimin pozitiv të kapaciteteve financiare të Universitetit, institucioni garanton se ka bilanc pozitiv dhe ka qëndrueshmëri financiare për të ardhmen.

### **Konkluzione të GVJ:**

- ✓ **Institucioni ka dokumentacion të rregullt financiar. Duke qenë pjesë e një shoqërie më të madhe, verifikimi i të dhënave është pjesë e institucioneve të tjera shtetërore.**
- ✓ **Institucioni deklaron se ka bilanc pozitiv financiar dhe qëndrueshmëri financiare për të ardhmen**
- ✓ **Institucioni bën auditim të rregullt vjetor dhe ruan raportet e gjendjes financiare të 3 viteve**
- ✓ **Institucion harton raport mbi të ardhurat nga tarifat dhe shpenzimet në funksion të procesit mësimor, të ardhurat nga grante dhe donacione të tjera, etj. Verifikimi i detajuar i këtyre raporteve financiare nuk është nën përgjegjësinë e ekspertit, por duke qenë pjesë e një kompanie dhe netëorku**

- më të madh, është e pritshme se të ardhurat studentore nuk përbëjnë burimet e vetme të financimit.
- ✓ Kriteret mbi auditivin, raportimin, standardet e financimit etj, vlerësoj se janë përmbushur

## 6. SISTEMI I BRENDSHËM I SIGURIMIT TË CILËSISË

### Pjesa përshkrimore

**TERMA REFERENCE:** institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njesisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë përbën një standard të rëndësishëm dhe një kërkesë të legjislacionit mbi arsimin e lartë. Funksionaliteti i tij është thelbësor për funksionalitetin e sistemit dhe të kontrollit të cilësisë. Referuar dokumenteve statusore të Universitetit, Këshilli i Vlerësimit Akademik dhe Zhvillimit të Cilësisë (KVAZHC) është struktura statusore e Universitetit EPOKA, përgjegjës për Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. Detyrat dhe përgjegjësitë e saj janë të përcaktuara në Udhëzimin "Mbi Vlerësimin Akademik dhe Përmirësimin e Cilësisë në Universitetin "Epoka" dhe aktet e tjera ligjore dhe administrative të Universitetit. Numri i anëtarëve përcaktohet nga Senati, mandati i tyre është dy vjet, përbërja aktuale e tij reflektohet në tabelën 20, faqe, 44, të RVB.

Universiteti deklaroi dhe solli dokumentacion ilustrues se ka reflektuar ndryshimet e reja mbi bazë Manualin për Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë (2012, APAAL). Qënia e shefit të departamentit edhe kryetar i KVAZHC nga 2016, është korrekte nga ana vendimmarrëse por krijon probleme në ushtrimin e kontrollit, pasi titullari i departamentit është edhe drejtues i njesisë së kontrollit të cilësisë.

Sipas konkluzioneve të dala nga shqyrtimi i dokumentacionit të Universitetit, si dhe takimeve me stafin akademik dhe stafin e KVAZHC, rezultatet e kontroleve ndahen me drejtuesit e fakultetit dhe stafin akademik me qëllim ndjekjen dhe përmirësimin e tyre në rast problematikash.

Universiteti Epoka ka ngritur një sistem funksional online dedikuar stafit akademik dhe ku vend të rëndësishëm zë edhe kontrolli i cilësisë, të dhënat për stafin akademik dhe ndjekja progresive e cilësisë së mësimin dhe të aktivitetit në universitet. Cdo fund semestri studentët bëjnë vlerësimin e pedagogut dhe të lëndës në formë elektronike bazuar në 14 kritere vlerësimi, vlerësimi i studentëve është konfidencial në të dhëna por i detyruar si proces periodik.

Pjesë e vlerësimit janë edhe format klasike e ligjore të testimit, - vlerësimit nga studentët, takimet, anketimet, verifikimet në raste flagrante, pjesëmarrja e dekanit ose drejtuesit të njesisë në leksione të veçanta të stafit akademik, fokus grupe me studentët dhe stafin etj.

Cdo vit universiteti, dhe për pasojë edhe njësitë përbërëse të tij, hartojnë një raport vetë-vlerësimi, i cili i paraqitet Këshillit të Lartë të Universitetit.

Universiteti raportoi se në kuadër të procesit të certifikimit ISO për Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë, Grupi i Auditit të Brendshëm kryen auditime periodike në çdo njësi akademike dhe administrative të Universitetit si dhe harton Raportin e Auditit të Brendshëm. Në funksion të cilësisë Auditit i Brendshëm zhvillon seminare informuese dhe trajnuese periodike me stafin e institucionit.



### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:
  - o Sa anketime kanë bërë me studentët
  - o Sa studentë janë anketuar
  - o Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë
  - o Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm
  - o Etj.
- Kontrolli i brendshëm i cilësisë
- Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti
- Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre
- Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike
- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

### VLERËSIMI SIPAS STANDARDEVE

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b> <b>Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;	Universiteti përmes akteve zyrtare funksionale të tij, ka krijuar metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese në funksion të secilit program mësimor, përfshirë edhe në atë bachelor për shkencë politike dhe marrëdhëniet ndërkombëtare. Procesi realizohet përmes KVAZHC.
<b>Kriteri 2</b> Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;	Institucioni i përfshin të gjitha informacionet në procesin vjetor të vetëvlerësimit institucional
<b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;	Institucioni i publikon raportet në faqen e tyre zyrtare dhe përdor të dhënat e dala nga KVAZHC dhe procesi i vetëvlerësimit të brendshëm në funksion të përmirësimit të gjendjes dhe reflektimin pozitiv në aspektin akademik dhe institucional
<b>Kriteri 4</b> Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:	Ekipi i ekspertëve pati mundësi të njihet me praktikën e vlerësimit të brendshëm dhe formave të kryerjes së tyre. Rezultoi se universitetit përdor metoda direkt dhe indirekte:
Të tërthorta: a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve; b. Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; c. Pyetje konceptuale;	Format indirekte të vlerësimit: <ul style="list-style-type: none"><li>• Universiteti aplikon anketime të ndryshme me studentët mbi procesin mësimor, lëndët, dhe problematikën e lidhur me to.</li><li>• Pjesë e anketimeve janë pyetjet mbi përmbajtjen e lëndës, performancën e</li></ul>



<p>d. Intervista; e. Etj.</p> <p>Të drejtpërdrejta:</p> <p>a. Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara); b. Dëgjime në auditor; c. Vlerësimi me nota/pikë; d. Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë; e. Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet); f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p>	<p>stafit, shërbimet e ofruara nga Universiteti, rekomandimet dhe kërkesat, etj.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pjesë e sondazheve janë elementë të didaktirës, programit, literaturës, formën e të mësuarit dhe vlerësimit të lëndës.</li> <li>• Universiteti përdor edhe fokus grupe, takime të përbashkëta të studentëve, etj, me tematika të ndryshme që lidhen me procesin mësimor.</li> </ul> <p>Format direkte të vlerësimit:</p> <p>Institucioni aplikon forma të ndryshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Testet në forma të ndryshme</li> <li>• Ndjekja e orëve të vecanta të lektorëve në auditor dhe vlerësim i cilësisë</li> <li>• vlerësime me notë dhe me pikë,</li> <li>• vlerësim të detyrave të kryera nga studentët, moduleve, provimet, etj.</li> <li>• vlerësim për përfshirjen në aktivitete sociale dhe në aktivitete të tjera të universitetit, etj</li> </ul>
<p><b>VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË</b> <b>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që</p>	<p>Universiteti ka kryer me sukses akreditimin institucional të tij (2011). Programi bachelor shkencë politike dhe marrëdhënie ndërkombëtare i akredituar është riorganizuar (2012) duke pësuar ndryshime nga sistemi katër vjecar me 240 kredite, në tre vjecar me 180 kredite. Pas riorganizimit nuk ka pasur procedure akreditimi të programit të ri, me argumentin se në Urdhrin e Riorganizimit dhe në Vendimin përkatës të Këshillit të Akreditimit nuk është kërkuar që programi i riorganizuar i studimit Bachelor në Shkencë Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare t'i nënshtrohet përsëri procesit të akreditimit.</p> <p>Institucioni, në zbatim të praktikave të përcaktuara nga MAS, përdor instrumentat standarde të sigurimit të cilësisë</p> <p>Institucioni disponon mekanizma, akte administrative dhe praktika pune që dëshmojnë se ka politika dhe procedura të qarta për vlerësimin periodik të cilësisë.</p>

<p>ofron;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Institucioni, mbi bazën e testimi vjetor të stafit dhe të studentëve, vlerëson edhe nevojën për ndërhyrje dhe përmirësime në programet dhe praktikatat e studimit</p> <p>Institucioni investohet në trajnimin dhe informimin e duhur të stafit dhe studentëve mbi rëndësinë e standardeve të cilësisë, si dhe praktikatat pozitive në këtë drejtim. Për shkak të natyrës së universitetit cilësia dhe jo sasia përbëjnë mekanizmin kryesor konkurrues të tij në treg.</p> <p>Universiteti Epoka disponon dokumente strategjike të miratuara nga strukturat drejtuese dhe të publikuara online, përmes të cilave synohet përmirësimi i vazhdueshëm i standardeve të mësimi dhe të cilësisë</p>
<p><b>Konkluzione të GVJ:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ <i>Universiteti ka kryer akreditimin institucional (2011) dhe ka përmirësuar në vlijueshmëri programet mësimore që lidhen me drejtimit e studimit, përfshirë shkencat politike e marrëdhëniet ndërkombëtare.</i></li> <li>✓ <i>Universiteti ka bërë riorganizimin e studimeve bachelor shkenca politike dhe marrëdhënie ndërkombetare (2012), proces qe nuk eshte shoqeruar me akreditim të programit të ri të ri-organizuar.</i></li> <li>✓ <i>Universiteti disponon një sistem online funksional dhe të teknologjisë së fundit për të mundësuar të gjithë procesin e vlerësimit të cilësisë në burime e forma të ndryshme</i></li> <li>✓ <i>Institucioni aplikon standardte e vendosura nga MAS lidhur me sigurimin e cilësisë dhe në fokusin e tij, i jep më shumë rëndësi standardeve të cilësisë sesa rritjes numerike të studentëve</i></li> <li>✓ <i>Universiteti ka plan strategjik mbi cilësinë, ka instrumenta matës të prekshëm dhe ka një sistem vetëvlerësimi efektiv</i></li> <li>✓ <i>Universiteti i plotëson në tërësi kriteret e përmendura në këtë kapitull</i></li> </ul>	


## POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

### 7. Programi i studimit, organizimi i tij

#### Pjesa përshkrimore

**TERMA REFERENCE:** misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Studimet Bachelor në Shkenca Politike dhe në Marrëdhënie Ndërkombëtare reflektojnë synimin institucional të fakultetit dhe universitetit EPOKA për të qenë konkurrues dhe lider në tregun arsimor. Programi specifik aspiron të formojë studentët me nivel kualifikimi konkurrues për studime të avancuara në këtë fushë, por edhe për prespektivë pozitive në sektorin publik, në sektorin privat, në angazhime në organizata civile brenda dhe jashtë vendit, si dhe në perspektiva të njëjta vendore, rajonale e



ndërkombëtare. Forca kryesore e programit bazohet në sistemin e studimit, në cilësinë e mësimdhënies, në aplikimin e anglishtes si gjuhë zyrtare mësimi si dhe në sistemin e shkëmbimeve studentore dhe të stafit akademik me institucione homologe jashtë vendit.

Në Bachelor Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare studentët marrin njohuritë bazë mbi këto dy drejtime studimi plotësuese me njëra tjetrën. Studimi i kombinuar fokusohet në bashkëveprimin midis teorive politike, institucionet dhe shoqërisë, si dhe funksionimin praktika të tyre. Formimi studentor në përfundim të këtyre studimeve u mundëson studentëve studime të avancuara, mendim të pavarur si dhe aftësi për ekspertizë në çështjet e trajtuara që lidhen me politikën dhe marrëdhëniet ndërkombëtare.

Studimet në bachelor shkenca politike dhe marrëdhënie ndërkombëtare organizohen me kohë të plotë dhe me 180 ECTS, 60 ECTS për vit. Viti akademik ka 28 javë, 14 javë në auditor. Studentët e parë në shkenca politike e marrëdhënie ndërkombëtare datojnë në vitin akademik 2008-2009.

Plani mësimor i studentëve reflektohet në tabelën nr.21, 22, 23, 24, 25, 26,27, faqe 50-61, të RVB.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi
- Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)
  - 1 vit akademik ka **28** javë mësimore në auditor
  - 1 Semestër ka **14** javë mësimore në auditor
- Në Planet mësimore të jepet ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit behet sipas RVB, faqe 53-54.

- Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara
- Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës
- Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.
  - 1) Emërtimi i lëndës/modulit
  - 2) Viti/semestri kur zhvillohet lënda
  - 3) Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
  - 4) Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
  - 5) Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës
  - 6) Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
  - 7) Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
  - 8) Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
  - 9) Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
  - 10) Format e vlerësimit të studentëve
  - 11) Detyrimet e studentit për lëndën
  - 12) Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse
- Dokumentacioni përkatës, i marrë në institucion

#### **VLERËSIMI SIPAS STANDARDEVE**

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA</b>	
<b>Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	



<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p>	<p>Programi Bachelor në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare ka pësuar ndryshime në strukturën mesimore më 2012 dhe pas riorganizimit në sistem 3 vjeçar nuk është akredituar duke e marrë të mirëqënë vijimin e statusit. Ai bazohet në sistemin evropian ETCS.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Bazuar në të dhënat e institucionit kreditit për student gjatë një viti akademik janë 60 ECTS dhe studentët kanë mundësi përzgjedhjeve të lëndëve vjetore për të përfituar kreditit e nevojshme</p>
<p><b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>  <b>Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;</p>	<p>Institucioni, përmes departamentit të Shkencave Politike dhe të Marrëdhënieve Ndërkombëtare si dhe Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative si njësi kryesore, ofron informacione të nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve. Informacioni është online dhe me akses publik. Regjistrimi mbi bazë mesatareje dhe njohuri të thelluara anglisht tregon se studentët kanë pasur informacionet e duhura paraprakisht dhe kanë bërë zgjedhje të ndërgjegjshme</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;</p>	<p>Njësitë kryesore ofrojnë në çdo rast, përmes sistemit online dhe aksesit të lirë në sekretarinë mësimore dhe seancat informative, informacion mbi lëndët me zgjedhje dhe detyruese për semestër. Nga takimi me studentët rezultoi se për shkak të numrit relativisht të kufizuar të studentëve, oferta e lëndëve me zgjedhje është e kufizuar edhe nga numri i studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;</p>	<p>Të gjitha informacionet e përcaktuara në këtë kriter, janë publike dhe aksesoren lirshëm edhe në sekretarinë mësimore, në departament dhe në zyrat e tjera me akses informativ për studentët. Kjo u konfirmua edhe nga nga studentët</p>
<p><b>Kriteri 4</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.</p>	<p>Institucioni ofron informacion të detajuar edhe mbi syllabuset, praktikat, ushtrimet etj, me akses të lirë në sekretari apo në sistemin e informacionit online të institucionit.</p>
<p><b>Konkluzionet e GVJ:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ <i>Institucioni ofron programe studimore në përputhje me sistemin evropian të vlerësimit ECTS</i></li> <li>✓ <i>Institucion ofron informacion të detajuar për studentët lidhur me programet, ngarkesat, përmbajtjen e lëndëve, lëndët me zgjedhje, etj.</i></li> <li>✓ <i>Njësitë drejtuese në departament dhe fakultet mundësojnë informacion të</i></li> </ul>	

✓ **detajuar për studentët mbi procesin mësimor dhe elementët përbërës të tij**  
**Kriteret e këtij kapitulli janë përmbushur.**

## **8. MËSIMDHËNIA**

### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Mësimdhënia në bachelor shkencat politike dhe marrëdhënie ndërkombëtare në Universitetin EPOKA organizohet nëpërmjet kombinimit të leksioneve dhe seminareve. Cdo lëndë është e pajisur me literaturën përkatëse, kryesisht me literaturë ndërkombëtare në anglisht. Në disa lëndë specifike ka edhe literaturë shqip, për shkak të programit të këtyre lëndëve, por në tërësi, sic u konfirmua edhe nga studentët, literatura shqip është minore në tërësinë e literaturës në dispozicion. Struktura e syllabuseve është e plotë dhe informative.

Vlerësimi i njohurive bazohet kryesisht në provim në formë të shkruar, por pedagogët mund të aplikojnë provim me gojë, projekt apo detyrë, sipas përcaktimeve paraprake në syllabus. Sistemi i kontrollit të provimeve është strikt, - tezat miratohen nga dekani, praktikë e ndjekur për arsye sigurie, kompetencë që sugjerohet të kalohet tek departamenti, si një standard më funksional dhe praktik.

Universiteti EPOKA ka aplikuar vlerësimin e njohurive sipas sistemit amerikan të krediteve dhe ECTS-së, e llogaritur sipas metodologjisë së përmendur në nenin 26 të Rregullores së Studimeve të Ciklit të Parë dhe Provimeve në Universitet.

Vlerësimi sasior i punimeve të studentëve bëhet me nota, sipas tabelës 29, faqe 64 të RVB.

Ngarkesa mësimore dhe forma e organizimit të mësimit reflektohen në tabelën 30, faqe 66 të RVB.

Forma e kontrollit të njohurive reflektohet në tabelën 31, faqe 66 të RVB.

Aktivizimi i studentëve në aktivitetet e njësisë reflektohen në tabelën 32, faqe 66 të RVB.

### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:
  - Leksione
  - Seminare
  - Ushtrime
  - Laboratore
  - Praktikë lëndore
  - Praktikë profesionale
  - Etj.
  
- Format e kontrollit të njohurive
- Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

## 9. STUDENTËT

### Pjesa përshkrimore

**TERMA REFERENCE:** procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Studentët e programit të studimit bachelor Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare, Universiteti EPOKA, pranohen pas një procesi informimi publik të maturantëve në shkollat e mesme në Tiranë dhe në rrethe. Universiteti ofron ture informative brenda tij për maturantët e interesuar. Kryesisht prurjet janë produkt i sistemit arsimor paraardhës të kolegjeve brenda të njëjtës shoqëri, por edhe me prurje të tjera, në varësi nga interesi i studentëve dhe cilësitë e tyre (mesatarja, interesi akademik dhe njohuritë e gjuhës angleze). Pjesë e rekrutimit janë edhe studentë nga Kosova dhe Maqedonia.

Numri i studentëve të rregjistruar në Programin Bachelor në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare në 5 vitet e fundit është 81 studentë, Numri i studentëve të diplomuar në këtë program studimi gjatë këtyre 5 viteve është 22 dhe kalueshmëria është në total është 42. (Tabela 34 ne RVB).

Universiteti aplikon si kriter preferencial mesatare të lartë pranimi, mbi 8.4 në vitin 2016, (shih tabela 34 ne RVB) dhe njohuri të thelluara në anglisht, por në takimin me studentët u konstatua se mesatarja nuk është statike dhe se niveli i njohurive në anglisht edhe brenda një kursi ka diferencime, një tregues i pritshëm brenda një komuniteti me prurje nga drejtime të ndryshme, por i paflektuar në RVB.

Nga verifikimet në Sekretarinë e institucionit të disa rasteve, rezultoi se të dhënat e detajuara për cdo student janë hedhur të plota dhe ruhen sipas standardeve ligjore. Grupi verifikoi edhe disa pasaktësi në të dhëna, kryesisht teknike, për të cilat u la detyrë të korrektohen për përputhje të plotë midis të dhënave të tyre dhe të dhënave në gjithë materialin integruar në RVB.

### Vlerësimi i Tregues të matshëm:

- Procedurat e pranimit të studentëve
- Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve
- Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë)
- Nota Mesatare
- Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse)
- Nota Mesatare
- Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend
- Të dhëna për punësimin e studentëve
- Numri total të diplomuarve
- Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)
- Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)
- etj

### VLERËSIMI SIPAS STANDARDEVE

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE</b>	
<b>Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve të rinj.</b>	



**Kriteri 1** Pranimit në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.

**Kriteri 2** Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.

Praktika e pranimit të studentëve në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin.

Universiteti ka kritere të veçanta përzgjedhësve, kryesisht të lidhura me mesataren (mbi 7), suksesin në maturën shtetërore dhe njohuritë e thelluara të gjuhës angleze. Në RVB citohet edhe limiti 6 për studimet në shqip, por ky nuk është rasti për studimet në shkencat politike e marrëdhënie ndërkombëtare, të cilat zhvillohen në anglisht. Universiteti nuk ka ndonjë kriter diskriminues, përkundrazi, mbetet i hapur edhe për prurje nga shtete të tjera, përfshirë Kosova e Maqedonia.

**Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.**

**Kriteri 1** Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;

**Kriteri 2** Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;

**Kriteri 3** Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;

**Kriteri 4** Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.

Institucioni ofron mekanizma e mundësi të shumëllojshme informimi për studentët, aplikantët dhe publikun, për programet e studimit, organizimi dhe kohëzgjatja e tyre. Studentët e konfirmuan këtë fakt nga përvoja e tyre personale.

Në përfundim të çdo semestri studentët bëjnë vlerësim konfidencial për çdo pedagog të lëndëve. Vlerësimet lidhen me cilësinë dhe tregues të tjerë të komponentëve të mësimdhënies. Rezultatet e nxjerra përbëjnë bazë referuese për ecurinë e kontratës së stafit akademik me institucionin.

Përmes zyrës së planifikimit të karrierës për studentët e diplomuar, institucionin mban të informuar studentët dhe ofron konsulencë të vazhdueshme për studime të avancuara apo ecurinë e karrierës në profesion.

Institucioni i jep rëndësi thelbësore sigurimit të lidhjeve të forta me tregun e punës dhe ecurinë e studentëve pas diplomimit. Çdo muaj prill organizohet parairi i punës, institucioni ka siguruar disa marrëveshje dhe kontrata me kompani të njohura, etj. Programi mësimor dhe fakti që zhvillohet në anglisht me një trupë ndërkombëtare pedagogësh vlerësohet si faktor plus dhe lehtësues për universitetin në këtë proces. RVB citon shifrën prej 89% të studentëve të angazhuar në studime të avancuara apo marrëdhënie pune pas përfundimit të studimeve bachelor në këtë program mësimor. Tabela 37 e RVB tregon se nga

	17 të diplomuar të brezit 2015-2016 tashmë 5 janë punësuar në profesion.
<b>Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;	Institucioni disponon statistika e dosje të personalizuarra për secilin student, për të diplomuarit dhe ecurinë e tyre gjatë viteve të ciklit të parë të studimeve. Gjatë vizitës u konstatua ky fakt.
<b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve;	Institucioni ka të dhëna të plota mbi regjistrimet, largimet, transferimet, ndryshimet e ndodhura në cdo semestër dhe vit akademik, si dhe ecurinë e rezultateve të secilit prej studentëve.  Institucioni ka të dhëna të plota mbi të gjithë procesin e aktivitetit dhe rezultatet e detajuara të secilit prej studentëve nga faza e regjistrimit deri në diplomimin përfundimtar.
<b>Kriteri 3</b> Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.	
<b>Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor;	Institucioni ofron këshillim cilësor (ka strukturë dhe proces të vazhdueshëm), aplikon sistemin e mentorimit nga studentët e brezave më të vjetër dhe stafit akademik, si dhe asiston cdo problematikë që lidhet me procesin mësimor.
<b>Kriteri 2</b> Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.	Zyra e planifikimit të karrierës për studentët e diplomuarit asiston studentët në vijimësi për praktikën profesionale, ofertat, marrëveshjet, mundësitë dhe ndjekjen praktike të zhvillimit të tyre.
<b>Konkluzionet e GVJ</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ <b>Institucioni aplikon standardet ligjore dhe transparencë në praktikën e regjistrimit të studentëve të rinj</b></li> <li>✓ <b>Institucioni informon studentët rregullisht për procesin mësimor, programin dhe problematikën e ndryshme, si dhe e asiston atë në sistemin e karrierës, këshillimin për punësim si dhe ndjekjen e praktikave profesionale</b></li> <li>✓ <b>Institucioni disponon statistika të plota për studentët gjatë gjithë procesit mësimor, ndryshimet si dhe rezultatet e tyre. Disa prej statistikave, për shkak se janë gjithnjë në ndryshim, meritojnë vëmendje më të madhe dhe azhurnim me zhvillimet e reja, si psh ndryshimet brenda institucionit dhe ecurisë së mësimit ashtu edhe në raport me të diplomuarit, të transferuarit, të punësuarit, etj.</b></li> <li>✓ <b>Institucioni ofron mekanizma transparentë e profesional të testimit të stafit akademik</b></li> <li>✓ <b>Institucioni ka krijuar marrëdhënie bashkëpunimi me shumë institucione shtetërore e njësi private, për të nxitur çështjen e punësimit, praktikës dhe interesit dypalësh për studentët.</b></li> <li>✓ <b>Institucioni ka një përqindje të lartë për vit akademik midis studentëve e pedagoëve (23 studentë dhe 15 pedagogë më 2016) ndaj ka një sistem</b></li> </ul>	

*mentorimi aktiv me studentët për problematikat e tyre lidhur me procesin mësimor, lëndët, aktivizimin social dhe shanset për karrierë në profesion apo studime të avancuara.*

✓ *Institucioni i plotëson kriteret e këtij kapitulli*

## **KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.**

### **10. Kërkimi shkencor**

#### **Pjesa përshkrimore**

**TERMA REFERENCE:** politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Komponenti i kërkimit shkencor përbën një nga dy prioritetet e rëndësishme të shpallura në misionin dhe objektivat e Universitetit EPOKA. Për shkak të natyrës studimore, programi bachelor i shkencave politike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare e ka të domosdoshme zhvillimin paralel të procesit, - proces mësimor dhe proces kërkimor shkencor.

Nga takimi dhe dokumentacioni i verifikuar në institucion rezultoi se ekzistojnë mekanizma promovues për anëtarët e stafit akademik që investohen në kërkimin shkencor, qoftë me forma klasike (mbështetje financiare për pjesëmarrje në konferenca të rëndësishme, zhvillim konferencash dhe aktivitetesh shkencore brenda universitetit, botim i artikujve shkencorë në revista me nivel impakti, etj), qoftë edhe me stimulime të veçanta, (vlerësimi me shpërblimi i autorëve me arritje shkencore brenda stafit akademik sipas përcaktimeve të rregullores për nxitjen e publikimeve shkencore në EPOKA. Nga takimi me stafin, të gjithë shprehën vlerësim për këtë politikë stimuluese megjithëse ata nuk konfirmuan ende rastet e para të përfitimit të vecantë financiar për shkak të këtij procesi.

Gjatë vizitës në institucion u provua se Universiteti EPOKA boton një revistë shkencore periodike, (Journal of European Social Research, botimi i fundit, mars 2015), se një pjesë me përvojë e stafit akademik ka një bilanc të pasur të artikujve e studimeve shkencore, publikuar në revista me impakt brenda dhe jashtë vendit, si dhe interesi i stafit akademik për studime e botime specifike në fushat e tyre të kërkimit shkencor. Vlen të theksohet se stafi akademik kishte në proces publikimin e botimeve profesionale (librave) nga disa anëtarë të stafit, por në këtë periudhë nuk ishin në gjendje të dëshmonin se stafi akademik është edhe autor tekstesh akademike dhe librash me nivel akademik. Argumenti se vetë natyra e programit (gjuhë anglisht dhe literaturë bazë botimet ndërkombëtare) nuk qëndron, pasi botimet e librave dhe studimeve nga stafi akademik është tregues cilësie dhe një prej kriterëve të vlerësimit të efektivitetit të tyre në nivelin shkencor.

Stafi akademik i shkencave politike dhe marrëvedhjeve ndërkombëtare, në bashkëpunim edhe stafin tjetër universitar, kanë kryer hulumtime dhe botime me interes publik e akademik edhe për problematika shqiptare, sic ishte botimi mbi perceptimin e çështjeve të politikës së jashtme dhe atyre social kulturore nga publiku shqiptar (2011), etj.

Universiteti EPOKA, përfshirë stafi i departamentit të shkencave politike dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare, ka marrë pjesë aktive në disa projekte ndërkombëtare, ka marrëveshje bashkëpunimi, ka programe shkëmbimore dhe dokumentacione e akte të tjera që dëshmojnë një bilanc pozitiv të angazhimit akademik brenda vendit dhe në



kuadër rajonal e ndërkombëtar. Pjesë e projekteve, e sistemit të shkëmbimeve akademike dhe e publikimeve dhe organizimit të aktiviteteve shkencore kanë qenë edhe studentët e interesuar të shkencave politike dhe të marrëdhënieve publike.

Të dhënat mbi numrin e botimeve, botimet kryesore, numrin e projekteve të fituara e të zbatuara, etj, gjenden në mënyrë më të detajuar në tabelat 39 dhe 40, faqe 75 dhe 76, të RVB.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Të dhëna për kërkimin shkencor
- Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL
- Numri i projekteve kërkimore të fituara
- Numri i projekteve të zbatuara
- Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL
- Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda iAL
- Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor
- Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor
- Numri i Çmimeve Kombëtare
- Dokumentacioni përkatës i marrë gjatë vizitave

#### **Konkluzionet e GVJ**

- ✓ *Institucioni ka politika stimuluese për kërkimin shkencor, mbështet me dokumente dhe akte zyrtare nismat e stafit akademik për kualifikim shkencor, ka një numër botimesh cilësore brenda e jashtë vendit, merr pjesë në konferenca të rregullta kombëtare e rajonale, pra nxit dhe mbështet thellimin e kërkimit shkencor dhe punën e stafit akademik në këtë drejtim.*
- ✓ *Institucioni nuk ka buxhet specifik për kërkimin shkencor dhe, në fushën e shkencave politike dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare është i forkuar më shumë në procesin e mësimin sesa të kërkimit.*
- ✓ *Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me qendra akademike e universitare, ka fituar projekte kërkimore, është partnere në disa të tjera dhe ka një bilanc në tërësi pozitiv në çështjet e kërkimit shkencor*

## **11. BASHKËPUNIMI KOMBËTAR, NDËRKOMBËTAR DHE MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN**

### **Pjesa përshkrimore**

**TERMA REFERENCE:** bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

### **Pjesa përshkrimore**

Universiteti Epoka i jep rëndësi zjerimit të bashkëpunimit me partnerë akademikë, tregtarë, institucione dhe ente të tjera brenda vendit, në kuadër rajonal dhe ndërkombëtar. Synimi i tij për të qenë lider në fushën e studimeve politike dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare e sheh mobilitetin e stafit akademik dhe bashkëpunimin me institucionet e tjera, si prioritet dhe pjesë integrale të procesit mësimor dhe akademik.

Bashkëpunimi realizohet përmes Zyrës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare (IRO) dhe përfshin stafin akademik dhe studentët. Institucion nxit dhe aplikon praktikatat verore

ndërkombëtare për studentët, programet e përbashkëta të diplomave me partner akademikë në rajon, shkëmbimet akademike, bursat ndërkombëtare të studimit, aktivitetet shkencore të përbashkëta, etj. Përmes IRO institucioni bën promovimin e programeve të tij ndërkombëtare, si dhe organizimin periodik të konferencave, eventeve, vizitave të lektorëve të huaj, udhëtimeve jashtë vendit, etj,

Një numër projektesh me të dhënat përkatëse për kohëzgjatjen dhe nivelin e anghazhimit të stafit akademik dhe të studentëve gjatë viteve, si dhe një numër marrëveshjes ndërkombëtare në fushën e shkencave politike dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare gjenden të përshkruara në mënyrë të detajuar në tabelat 41, 42, 43, 44 etj, faqe 78-82 të RVB.

Vlen të theksohet fakti se Univeristeti EPOKA është një nga universitetet e pakta në Shqipëri që ka rezultate konkrete në shkëmbimin akademik sezonal të studentëve. Konkretisht, rreth 16 studentë kanë kyer studime semestrale në një nga universitetet partnere të universiteti EPOKA në vendet e tjera, kryesisht në Turqi, si dhe anasjelltas, kanë mirëpritur studentë të huaj në Shqipëri. Detajet gjenden në tabelën 45 dhe 46, faqe 82 dhe 93, të RVB.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar
  - Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare
  - Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj
  - Numri i pjesëmarrësve në trainime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit
  - Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL
  - Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor
  - Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore Jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime
  
- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë:
  - Institucionet qeveritare bashkëpunuese
  - Organizatat Profesionale
  - Komuniteti i biznesit, tregu i punës
  
- Dokumentacioni përkatës

#### **VLERËSIMI SIPAS STANDARDEVE**

<b>Standardet/kriteret</b>	<b>Përmbushja e standardeve</b>
<b>VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME</b>	
<b>Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;	Institucioni, bazuar në dokumentet zyrtare të tij dhe në konkluzionet e nxjerra nga takimi me stafin akademik, ndjek politika të qarta nxitëse për bashkëpunimin brenda tij, për ndryshime, përmirësime dhe nisma në kërkimin shkencor.
<b>Kriteri 2</b> Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit	Universiteti ka mekanizma koordinues dhe dhe praktika konsultimi të vbazhduesëm, të cilat

brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.

bëjnë të mundur ndëtimin e marrëdhënieve të frytshme midis personelit akademik. Kompetencat janë përcaktuar qartësisht në aktet zyrtare të Universitetit

**Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.**

**Kriteri 1** Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj

**Kriteri 2** Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë;

**Kriteri 3** Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;

**Kriteri 4** Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.

Universiteti EPOKA provon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me një numër të madh institucionesh akademike homologe brenda vendit, në rajon dhe më gjerë, me aktorë të biznesit vendas e të huaj, me institucione shtetërore dhe publike, etj, në funksion të objektivave të tij.

Institucioni i jep mbështetje realizimit të praktikave profesionale nga studentët, kryesisht sipas preferencave të tyre. Për këtë institucioni ka kontrata dhe marrëveshje bashkëpunimi me një sërë institucionesh, përfshirë edhe me punëdhënësit, tregun dhe organizata të shoqërisë civile.

Institucioni, në përputhje me standardet e ISO inicion vazhdimisht tranime profesionale në bashkëpunim me punëdhënësit dhe partnerë të tjerë institucionalë

Institucioni raporton se për shkak të natyrës së themelimit dhe funksionimit të tij, nuk e ka konsideruar si të domosdoshme marrjen e shërbimeve nga palët e treta, për realizimin e programeve të studimit, duke i plotësuar këto nevoja me burimet e veta.

**Konkluzionet e GVJ**

- ✓ ***Institucioni reflekton marrëdhënie pozitive bashkëpunimi midis personelit dhe strukturave funksionale e vendimmarrëse brenda tij, në funksion të kërkimit shkencor, përmirësimit të programeve mësimore dhe rritjes së cilësisë.***
- ✓ ***Institucioni ka marrëveshje me një numër të madh universitetesh partnere brenda vendit, në rajon dhe në nivel ndërkombe, si dhe ka programe konkrete shkëmbimi midis stafit dhe sidomos edhe midis studentëve***
- ✓ ***Institucioni ka marrëveshje aktive edhe me institucione të administratës publike në nivel qendror dhe vendor, si dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj***
- ✓ ***Kriteret e vendosura në këtë kapitull janë të përmbushura***



## ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

### I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

#### a. Pika të forta:

1. Universiteti ka prioritete të qarta për fuqinë dhe potencialin konkurrues për të qenë institucion me peshë specifike në fushën e shkencave politike dhe të marrëdhënie ndërkombëtare
2. Menaxhimi i institucionit është ndërkombëtar dhe me standarde të larta, kushtet dhe ambientet janë shumë cilësore, infrastruktura dhe kapacitetet për të ardhmen janë të garantuara
3. Zhvillimi i mësimin në gjuhën angleze dhe ekzistenca e një stafi të përhershëm ndërkombëtar përbën një pikë të rëndësishme dhe të veçantë të tij
4. Programet mësimore dhe literatura bazë reflektojnë trendin e shkencave politike dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare në nivel global
5. Lidhja e fortë midis ofertës akademike dhe shanseve për promovim e punësim në të ardhmen në sektorin publik e privat në Shqipëri e rajon
6. Sistemi funksional elektronik, kontrolli i cilësisë, strukturat harmonike dhe respekti për studentin mbeten cilësi të rëndësishme pozitive të Universitetit EPOKA
7. EPOKA ka bashkëpunim intensiv me institucione homologe brenda e jashtë vendit, ka bilanc pozitiv të praktikës dhe sistemit të shkëmbimeve sekretare midis studentëve
8. Imazhi pozitiv publik i universitetit, rezultatet e larta të studentëve që kanë studiuar aty dhe kanë vijuar me studime të avancuara jashtë vendit, si dhe konsensualiteti midis stafit ndërkombëtar dhe studentëve për parimet kryesore të funksionimit të universitetit dhe standardeve më të larta të mësimdhënies
9. Përpjekja maksimale për zbatimin në kohë të detyrimeve ligjore, transparenca e plotë e akteve universitare në internet, si dhe aksesit për transparencë dhe rol të dobishëm në zhvillimet shoqërore në Shqipëri.
10. Numri i lartë i stafit akademik për numër studentësh dhe cilësia teknike e realizimit të mësimin dhe programit të lëndës

#### b. Pika të dobëta:

1. Problemet e menaxhimit që burojnë nga diversiteti kulturor dhe heterogjeniteti i stafit akademik
2. Standardet e anglishtes që vijnë nga arsimiti i mesëm dhe problematikat për të pasur një nivel horizontal të dijeve nga studentët e të njëjti kurs
3. Fokusimi kryesisht tek studentët e sistemit zinxhir të shkollave, fokusimi vetëm në literaturën e huaj, fokusimi në drejtime studimore të cilat i dedikohen më shumë tregut rajonal dhe ndërkombëtar sesa atij vendor
4. Sistemi i drejtimit në formë piramidale, lidhja piramidale me financimin dhe natyra vertikale e vendimmarrjeve të rëndësishme brenda fakultetit dhe universitetit
5. Mbështetja e kufizuar për kërkimin shkencor dhe sidomos angazhimin e stafit në institucione ndërkombëtare dhe botime ndërkombëtare
6. Oferta e kufizuar në mjedise plotësuese sociale për studentët që bëjnë jetën e një kampusi universitar
7. Numri jo i lartë i prurjeve të studentëve në vitin e parë dhe numri jo i lartë i stafit akademik me përvojë të gjatë e konkurruese akademike

8. Problemet e gjuhës shqipe për stafin e huaj dhe për pasojë probleme në pamundësinë e njohjes direkte dhe aktive të zhvillimeve sociale e politike në vend
- 1) RVB evidenton si pikë të dobët numrin e kufizuar të literaturave në funksion të këtij programi Bachelor në Shkencat Politike dhe sigurimin e literaturës elektronike, të evidentuara edhe nga grupi ynë.

**c. Mundësitë:**

1. Zgjerimi i kapaciteteve të studentëve me prurje më horizontale nga shkollat e mesme dhe e stafit me cilësi më të mëdha akademike
2. Tendenca drejt modelit të mësimit ndërkombëtar, - globalizimi i formave të mësimit, programeve dhe shanset që ofron një program 100% në gjuhën angleze dhe me bazë literaturën e huaj
3. Mundësi ende të pashfrytëzuara në kapacitet e nevojshme për pjesëmarrje e konkurrencë pozitive në programe komunitare e ndërkombëtare, sidomos në programet e Bashkimit Evropian
4. Nevojat në rritje të tregut të brendshëm për ekspertë të rinj, njohës aktiv dhe cilësor të shkencave politike dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare
5. Mundësia më e madhe për zgjerim të studentëve me prurje nga vendet fqinje dhe zgjerimi i programeve semestrale të shërbimeve për studentët e stafin akademik
6. Trendi i studimeve plotësuese online dhe i zgjerimit të formave të praktikave dhe të kooperimit midis njësisë mësimore dhe studentëve & stafit akademik

**d. Pengesat:**


1. Vështirësitë për një sistem konkurrues vlerash në fushën e arsimit, zhvillimet gjeopolitike dhe konkurrenca e investimeve të huaja në Shqipëri e rajon
2. Ndryshimet e vazhdueshme në legjislacionin e arsimit të lartë, natyra burokratike e adresimit të problemeve midis administratës publike dhe universiteteve jopublike
3. Ndikimi krizës financiare në Shqipëri dhe në rajon dhe niveli i lartë i papunësisë/emigrimit midis popullsisë së re në moshë
4. Problematika me informalitetin në treg, në arsim, në bazën e të dhënave dhe në kulturën e partneritetit midis institucioneve

## **SUMMARIZED ANALYSIS ON THE ASSESSMENT OF THE STUDY PROGRAM**

### **II. THE RJV SUMMARY ANALYSIS ACCORDING TO THE SWOT METHOD**

**e. Strengths:**


1. The Epoka university has established clear priorities on further developing its competitive edge in the fields of political science and international relations;
2. The Epoka university has an international management team and strives towards high standards in terms of premises and potential for their future development;



3. Classes are delivered in English with the permanent presence of international lecturers so as to provide for the highest standards of quality and academic achievement;
4. The curricula and the supporting literature are oriented towards the most recent global developments in the field of political sciences;
5. There is a strong link between academic attainments of the students and their career development in the public and private sector in Albania and in the region;
6. A functioning quality control system is in place, so as a well-designed administrative structure. There is a clear focus on striving for self-motivated student's attainments;
7. The Epoka University maintains a continuous and direct contact with peer institutions inside and outside Albania; it has a positive track record in the fields of academic and student exchange;
8. The public image of the Epoka university is positive thanks to the harmonious working relationship between its local and international lecturers and to good results of its students who pursued post-graduate studies abroad;
9. The university responds on time and properly to its legal compliance requirements. It provides for the full disclosure of its statutory acts and documents that are available online, pursuant to its committed to transparency as one of the most important conditions for Albania's social development;
10. The university has a low student to lecturers' ratio, and high standards of teaching and delivery of its curricula.

**f. Weaknesses:**

1. Management problems arising from cultural diversity and the heterogeneity of the academic staff;
  2. Problems related to English language proficiency as a result of the poor quality of English teaching in some high schools accounts for differing starting points amongst different students attending the same courses;
  3. The dominance of foreign source literature and the focus on disciplines that are geared more towards employment profiles that are more in demand in the region than domestically;
  4. A pyramidal management system, especially with regard to access to financing, and a highly centralized decision-making process on important decisions regarding the university departments;
  5. Limited support to academic research and a low level of engagement of the university staff in international research and international academic publications.
  6. Limited availability of social amenities for students, so that they can have sufficient social engagements within the university campus;
  7. A limited number of registered students in the first year of studies and a limited number of long-standing academic staff;
  8. Lack of Albanian language skills among international staff makes their access to the knowledge on the country's social and political developments rather difficult.
- 1) RVB considers the limited availability of resource literature for the Political Sciences Bachelor Programme and the limited access to electronic political sciences textbooks as a weak point.





**g. Opportunities:**

1. It is quite possible to increase the capacities of the students by diversifying and widening the pool of high schools from which they are identified for enrolment in the Epoka University; it is also possible to improve the quality of the academic staff;
2. There is a possibility to further strive towards the internationalisation of the teaching methods and the globalisation of teaching methodologies, curricula and the maximisation of the opportunities provided by curricula delivered 100% in English;
3. There are untapped potentials to participate in international and EU-funded programs on education;
4. The domestic market has a growing need for new experts who are knowledgeable in political sciences and international relations;
5. The university has a clear potential to attract students from the neighbouring countries by further extending the program of the courses provided for each semester;
6. The new trends related to the completion of complementary online courses, to the internships and to the new methods of cooperation between the academic staff and the students have clear development potentials.

**h. Threats:**

1. Albania suffers from a plethora of difficulties with regard to setting up a competitive, merit-based educational system, also taking into account its geopolitical challenges and the competition for foreign investments in the region;
2. The frequent changes in the legislation regulating higher education, the highly bureaucratic approach and the often inflexible relationships between public administration bodies and non-public universities;
3. The negative impact of the global financial crisis in Albania and in the region and the high level of unemployment/emigration of young citizens from Albania;
4. The high level of informality in the education sector and the lacking culture of partnership between different institutions.

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm**

1. Prof. As. Dr. Afrim Krasniqi

